



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

V E N D I M

Nr. 3, datë 18.10.2013

**PËR
MASAT EMERGJENTE TË NDËRHYRJES MBROJTËSE
DHE REHABILITUESE NË ZONËN ME RËNDËSI TË VEÇANTË TË
KURORËS SË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 3, 6, 8, 18/2, 26 dhe 32, të Ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar, të VKM-së, nr.676 datë 20.12.2002, “Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës Shqiptare”, VKM-së nr. 887, datë 03.10.2013 “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Përcaktimin e atyre zonave ku do të ndërmerren masa të natyrës emergjente me qëllim mbrojtjen dhe rehabilitimin mjedisor të Kurorës së Tiranës, sipas hartës bashkëlidhur.
2. Pezullimin e dhënies së të gjitha llojeve të lejes zhvillimore në zonat e Kurorës së Tiranës, nga autoritetet e planifikimit deri në miratimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar.
3. Deri në miratimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar, autoritetet e planifikimit lejohen të japin leje zhvillimore në këto zona, vetëm për këto raste përjashtimore:

- a. Punime mirëmbajtjeje;
 - b. Leje zhvillimore për interes publik, shtetëror dhe kombëtar.
4. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Mjedisit, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Kulturës, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/ Ndërtimeve Informale dhe Inspektoriati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar, për marrjen e masave emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese në këto zona.
 5. Ngarkohen autoritetet e planifikimit për ndjekjen dhe zbatimin e pikave 2 dhe 3 të këtij vendimi.
 6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETARE E K.K.T

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT




SEKRETARE E KKT

ADELINA GRECA

**DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË
TERRITORIT**


